



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 173/14 Prot.

Tiranë, më 22.01.2021

**VENDIM**

Nr. 6 datë 22.01.2021

**PËR  
NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË SIGURIMIT TË  
STANDARTEVE TË CILËSISË, BOTIMEVE DHE PROJEKTEVE SHKENCORE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, neni 46, Statutin e UST-së, neni 26 si dhe në propozimin e Rektorit të UST-së me shkresën Nr. 158 Prot., datë 20.01.2021 “Propozim për krijimin e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të dates 22.01.2021,

**VENDOSI:**

- 1- Të ngrihet Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore me përbërjen si më poshtë:
  - 2 (dy) anëtarë të stafit akademik të IKSHS
  - 1 (një) nga Zv/Rektorët
  - Nga 1 (një) anëtar nga njësitë kryesore FVFR dhe FSHL
  - Administratori i UST-së
  - 1 (një) anëtar i zgjedhur nga përfaqësuesit e studentëve

- 2- Të hapë thirrjen për vetëkandidimin e personelit akademik të kategorisë “Profesor”
- 3- Komisioni pas konstituimit të hartojë Rregulloren dhe kompetencat e tij lidhur me objektin e punës së përcaktuar.
- 4- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof.Dr. Agron KASA**

